

**Merr: Komisioni për peticione
i Bundestag-ut gjerman
Platz der Republik 1**

D - 11011 Berlin

Peticion për mjekim psikoterapeutik në gjuhën amtare, që merr parasysh kulturën, për migrantë

Lutemi që Komisioni për peticione ta këshillojë Bundestag-un që të miratojë ndryshimin e Kodit Social si vijon: Në Gjermani si vend imigrimi duhet të jëtë e mundur psikoterapia në gjuhën amtare si shërbim social, veçanërisht si shërbim i rregullt i sigurimit shëndetësor. Për këtë psikoterapi nevojiten psikoterapeutë/e që kuptojnë e respektojnë kulturën (gjininë, gjuhën amtare etj.) të pacientëve.

Kërkesat veç e veç:

1. Katalogu i shërbimeve mjekësore të shëndetësisë duhet të përfshijë një formë të psikoterapisë që merr parasysh kulturën (gjininë, gjuhën amtare etj.), për të rritur, të rinj dhe për fëmijë.
2. Duhet të krijohen struktura për finalizimin e “Pikave kryesore për përmirësimin dhe pranimin e diplomave të huaj” që u miratuan nga Qeveria federale gjermane, me qëllim që të pranohen më shpejt diplomat dhe përvojat profesionale të prura nga vendlindja. Në rast nevoje duhet t’u ofrohen migrantëve masa kualifikuese për të fituar një liçensë.
3. Në ndarjen e ordinancave nga komisionet për liçensat e psikoterapeutëve duhet të krijohet një kuotë për psikoterapeutë/e që e dijnë gjuhën amtare, me qëllim që t’u sigurohet mjekimi edhe atyre pacientëve që kanë nevojë për psikoterapi në gjuhën amtare.
4. Në qoftë se nuk ka psikologë/e ose psikoterapeutë/e që e kuptojnë e respektojnë kulturën dhe gjuhën amtare të pacientëve, sigurimet shëndetësore duhet të detyrohen të paguajnë përkthim të përstatshëm, me përkthyes/e profesionalë/e të shkolluar(a) në këtë fushë.
5. Përveç kërkesave të lartpërmendura, kërkojmë projekte kërkimesh me qëllim të fitohet njohe shkencore të sigurtë
 - rreth shëndetit shpirtëror të migrantëve dhe mjekimit të tyre
 - rreth numrit, kualifikimit dhe vendlindjeve të psikoterapeutëve të huaj që jetojnë në Gjermani

- rreth pasojave për shëndetin e migrantëve në rastin e psikoterapive që nuk e marrin parasysh kulturën e pacientëve.

Arsyetim

Ekspertat, odat e psikoterapeutëve në republikat e ndryshme të Gjermanisë, shoqata të ndryshme të lëmit etj. konstatojnë se mjekimi psikologjik për migrantë e refugjatë nuk është i siguruar në mënyrë kualitative - sipas hartuesëve të dymbëthjetë principeve drejtuese të Sonnenberg-ut të 2002-tës¹ - në Gjermani. Kjo mungesë i cenon në mënyrë të veçantë fëmijët dhe të rriturit që janë migrantë. Psikoterapi që merr parasysh kulturën e gjininë, për këta njerëz praktikisht nuk ka ose vetëm në mënyrë plotësisht të pamjaftueshme.² Kjo mungesë i cenon edhe femrat që kanë përjetuar dhunë sepse ato normalisht kanë nevojë patjetër për femra si psikoterapeute dhe psikoterapi në gjuhën amtare. Në këtë aspekt në shumicën e rasteve nuk ekzistojnë mundësi të mjaftueshme. Përveç asaj mungojnë edhe mundësi të “sigurta” për psikoterapi për të huaj që jetojnë në të zezën në Gjermani ose që janë ende në procedurën e azilit. Sipas raportit të Komisionit Evropian me datën 26.11.2007 situata në Gjermani në këtë aspekt e shkel ligjin e Bashkësisë Evropiane! Ligji i BE-së i detyron shtetet e BE-së – pra edhe Gjermaninë - për mjekimin³ e të huajve që kanë më tepër nevojë për mbrotje^{4 / 5}: sipas ligjit të BE-së “personat që kanë më tepër nevojë për mbrotje” janë ata “që kanë përjetuar torturë, përdhunim ose forma tjera të rënda të dhunës fizike, psikike ose seksuale”.^{3 / 6}

Për shkak të mungesës së mundësive pacientat duhet të presin shumë kohë ose shpeshherë nuk gjejnë mjekim fare. (Institucionet e mjekimit në gjuhën turke të Berlinit tregojnë se zakonisht pacientat duhet të presin dy vite për ta filluar mjekimin.)

Pa mjekim psikoterapeutik adekuat , sëmundjet shpeshherë bëhen kronike dhe mundojnë jo vetëm pacientat por edhe tërë familjen e tyre, në radhën e parë fëmijët, dhe shkaktojnë shpenzime të shmangshme të shëndetësisë.

Nga ana tjetër, në Gjermani jetojnë psikoterapeutë/e nga vende të ndryshme, që janë të aftë të zbatojnë psikoterapi në gjuhën amtare, duke marrë parasysh kulturën e gjininë. Shumë prej tyre për arsye të ndryshme (p. sh. sepse vendlinja e tyre nuk është anëtare e BE-së) deri më tani s’kanë mundësi që të nihen diplomat dhe përvojat e tyre të fituara në vendlindje dhe të fitojnë një licensë. Shumë psikoterapeutëve tjerë të huaj, edhe pse licensën e kanë, kohë të gjatë u refuzohet leja të hapin një ordinancë për mjekime të paguara nga sigurimi

1

2

3

⁴ 2003/9/EG vom 27.10.2003, Amtsblatt der Europäischen Kommission 2003 L 31

⁵ 2004/83/EG vom 29.04.2004, Amtsblatt der Europäischen Kommission 2004 L 304

⁶ Thüringer Erklärung: Sicherung der Rehabilitation von besonders schutzbedürftigen Flüchtlingen. Baff, IPPNW, Bundesärztekammer, DTPPP, DeGPT, Diakonie, Pro Asyl etc.

http://www.baff-zentren.org/index.php?option=com_content&view=article&id=59:eu-richtlinien&catid=46:eu-richtlinien&Itemid=66 und: www.refugio-vs.de/downloads/files/32/BAfF_Thüringer_Erklärung.pdf

shëndetësor. Me tërë kualifikimin që kanë për ta zbatuar psikoterapinë në gjuhën amtare, duke marrë parasysh kulturën e gjininë, ata nuk e marrin lejen, sepse gjoja ka psikoterapeutë të tepërtë. Për krejt ato arsye, në Gjermani ka shumë nevojë për psikoterapi në gjuhën amtare. Për të fituar shifra të sakta, është i nevojshëm një hulumtim shkencor ku mblidhen statistika për nevojën e vërtetë për psikoterapi të tillë, si dhe të regjistrohen numrat, kualifikimet dhe vendlindjet e psikoterapeutëve të huaj që jeteojnë në Gjermani.

Aspekte juridike:

Edhe pse politika evropiane ndaj imigrimit, ligji gjerman për imigrim sikur dhe politika e hapjes ndërkulturore në shëndetësinë gjermane e formojnë kornizën për imigrim të ligjshëm në Gjermani, Gjykata sociale federale i refuzon kërkesat e pacientave ndaj sigurimit të tyre shëndetësor për pagesën e përkthimit kur gjuhën gjermane nuk e zotërojnë (në mënyrë të mjaftueshme). Kjo gjykatë arsyeton se gjuha zyrtare si dhe gjuha e gjyqit është gjermanishtja. Ky arsyetim nuk është i bazuar sepse në ligjin social gjuha zyrtare është vendimtare vetëm në procedurën administrative, por jo në marrëdhëniet e psikoterapeutëve me pacientat e tyre. Argumenti tjetër i Gjykatës sociale federale, se gjoja kompetenca gjuhësore është shërbim vetëm plotësues i mjekimit, nuk merr parasysh se në psikoterapi komunikimi nuk është punë e dorës së dytë por *parakushti i parë*, pra çështja kryesore e mjekimit. Pra psikoterapia e zbatuar në gjuhën gjermane nuk e plotëson kërkesën e përligjur të pacientave të siguruar në ato raste ku pacientat nuk e zotërojnë fare ose shumë pak gjuhën gjermane. Edhe ata persona kanë një të drejtë për mjekim në nivelin më të fundit të shkencës. Kjo do të thotë se në rast nevojë u takon një psikoterapi në gjuhën amtare që merr parasysh kulturën e gjininë.

Gjykata sociale federale ka të drejtë me argumentin e saj se gjuha amtare i pacientit nuk është gjithmonë parakusht i domosdoshëm i mjekimit psikoterapeutik, pasi që shumë njerëz të huaj janë plotësisht të integruar në kulturën dhe gjuhën gjermane. Mirëpo për disa grupe njerëzish të poshtëpërmendura kompetenca gjuhësore është shpeshherë aq e kufizuar sa psikoterapia në gjuhën gjermane bëhet e pamundur:

- migrantë mbi moshën 60 vjeçare që në të kaluarën s'kanë marrë pjesë në ndonjë kurs të gjuhës,
- pacienta, që s'kanë shumë kohë që rijnë në Gjermani dhe gjuhën ende nuk e zotërojnë,
- pacienta me sëmundje psikike sikur depresion, psikozë, konsum drogash, demencë, traumatizime.

Te grupi i fundit, d.m.th. te pacientat me sëmundje psikike, një simptom kryesor është cenimi i koncentrimin dhe i mësimin. Si pacienta në psikoterapi me kufizimet e përmendura, në mënyrë të veçantë ata pacienta kanë nevojë për mjekim në gjuhën amtare.

Qëllimi i këtij peticioni është mjekimi psikoterapeutik për migrantë në gjuhën amtare që merr parasysh në mënyrë të mjaftueshme kulturën e gjininë të tyre.